



www.legjislatiioni.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 5

Tiranë – E hënë, 6 mars 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 2679, datë 27.7.2017	Për shitje..... 3



**NJOFTIM
I MINISTRISË SË FINANCAVE**

Nr.2679, datë 27.2.2017

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të VKM nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

1. Në administrim të Ndërmarrjes së Seleksionimit të Metaleve, Elbasan.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1.	“Magazina e Materialeve PJ-13”, “Dushe, Gardërobë tipi nr. 3”	Elbasan	3 671 007	2 823 459	847 548	3 622	600	28.3.2017	10.00	DDPP
2.	“Reparti i Përpunimit Mekanik nr. 29 A”	Elbasan	5 846 888	5 411 412	435 476	1 113.75	534.6	28.3.2017	11.00	DDPP
3.	“Kaldaja Provizore nr. 41”	Elbasan	1 967 454	1 502 555	464 899	1 189	189	28.3.2017	12.00	DDPP

Shënim. Objekti bashkë me truallin “Kaldaja Provizore nr. 41” është dhënë me qira për një periudhë 20-vjeçare, nga data 12.5.2014 deri më datë 12.5.2034 sipas kontratës së qirasë nr. 385 Rep, nr. 175 Kol, datë 12.5.2014.

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.

2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.

3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim: Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.



Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2017